

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Kapetanović: Kriminelët bashkëpunojnë pa deklarata, rajoni duhet të jetë po aq i shpejtë
ADRESA	https://a2news.com/rajoni-bota/ballkani/kapetanovi-inelet-bashkepunojne-pa-deklarata-rajoni-duh-i1185208
BURIMI	a2news.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 16:07:22 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 16:01:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	04bb484934acf2c61b722c1b8b4d76550598a9fbab5c264343121391347aab56
TEKSTI	0cb5b7de5f4987ed7b7620c5a2181f9527f7d78610f60ae4bdde7a2a6edac28d
PAMJA	808c6e8592ae39d0e3e5d127db300e158cc39ba8b6ff5acb39309b354e60f7e6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0c0302d230710c1398478a41c80a593c5752ea95f4d0be1c1a08851858fa4dc2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6d78d2dc60f31cde5fa6ff278c9155b75ea76fff53014b2b93764708aa00c94f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0c0302d230710c1398478a41c80a593c5752ea95f4d0be1c1a08851858fa4dc2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Kapetanović: Kriminelët bashkëpunojnë pa deklarata, rajoni duhet të jetë po aq i shpejtë

Nga A2 CNN
16 Shtator 2026, 18:01 | Ballkani



Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, Amer Kapetanović, ka kërkuar intensifikimin e bashkëpunimit mes vendeve të Ballkanit Perëndimor në luftën kundër krimit të organizuar, duke paralajmëruar se rrjetet kriminale veprojnë përtej kufijve më shpejt se institucionet që duhet t'i luftojnë.

Duke folur në Takimin e Ministrave të Brendshëm të Procesit të Berlinit, të zhvilluar më 15 dhe 16 shtator në Podgoricë, Kapetanović tha se goditja e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor nuk është vetëm çështje e sigurisë së rajonit, por edhe e sigurisë evropiane.

"Çdo dërgesë e ndaluar në rajonin tonë është një dërgesë që nuk do të duhet të ndalet në Vjenë, Berlin, Paris apo Londër. Kjo nuk është vetëm e dobishme për rajonin, por është siguri për të gjithë ne. Kriminelët bashkëpunojnë përtej kufijve tanë pa deklarata të përbashkëta. Le të bashkëpunojmë të paktën po aq shpejt", tha ai, përcjell A2.

Takimi u zhvillua në Vila Gorica, nën Kryesimin e Malit të Zi të Procesit të Berlinit për vitin 2026. Kapetanović foli në sesionin kushtuar forcimit të qëndrueshmërisë ndaj krimit të organizuar, ku morën pjesë përfaqësues të Gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor, Komisionit Evropian dhe partnerëve ndërkombëtarë.

Sekretari i Përgjithshëm i RCC-së solli në vëmendje edhe perceptimin e lartë të qytetarëve për korrupsionin dhe krimin. Sipas të dhënave më të fundit të SecuriMeter të RCC-së, 81% e qytetarëve të anketuar besojnë se korrupsioni është i përhapur, ndërsa 72% shprehin shqetësim për krimin e organizuar.

Kapetanović kërkoi përdorim më të mirë të të dhënave dhe provave rajonale për identifikimin e boshllëqeve në siguri, si dhe më shumë vëmendje ndaj porteve, rrjeteve të transportit dhe logjistikës, të cilat mund të shfrytëzohen nga grupet kriminale.

Sipas tij, nevojitet gjithashtu bashkëpunim më i ngushtë ndërmjet policisë, doganave dhe operatorëve logjistikë, si dhe forcim i lidhjes ndërmjet sigurisë së personelit, informacionit dhe sistemeve digjitale.

Një tjetër fushë ku Kapetanović kërkoi vazhdimin e bashkëpunimit rajonal është kontrolli i armëve të zjarrit. Ai iu referua përvojës së krijuar përmes Udhërrëfyesit të Ballkanit Perëndimor për Kontrollin e Armëve të Vogla dhe të Lehta dhe bashkëpunimit me SEESAC.

Sesioni u drejtua nga ministri i Punëve të Brendshme i Malit të Zi, Danilo Šaranović, ndërsa në diskutim morën pjesë përfaqësues të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të Komisionit Evropian.

Diskutimi për sigurinë rajonale do të vazhdojë në Konferencën Rajonale të Sigurisë JUMBO. të cilën RCC do ta organizoi në Tiranë në nëntor. Konferenca do të fokusohet te

TE FUNDIT

🕒 Në pritje të vendimit, njerëzit që formësuan luftën e Kosovës

Plagosje me armë zjarri në Durrës

Vendimi në Hagë, reagon AKB: Kosova rrezikon të paguajë edhe çmimin ekonomik

Dënimi i krerëve të UÇK-së në Hagë, reagon Marta Kos: Vendimet duhet të respektohen

MË TË VIZITUARAT

Tragjedi në Sudan, shembet miniera e arit, të paktën 60 të vdekur, dhjetëra t...

Detajet e verdiktit për ish-krerët e UÇK-së: Çfarë konstatoi trupi gjyqësor?...

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së, reagon Mbretëria e Bashkuar: Vendimi të mos p...

LIVE UPDATES

Mbretëria e Bashkuar paralajmëron paketë të re sanksionesh ndaj Rusisë

LIVE | Gjithçka rreth Samitit Ukrainë-Europa Juglindore

Blinken në Tiranë, vizita e Sekretarit Amerikan të Shtetit në Shqipëri

efektiviteti i mbështetjes për institucionet e sigurisë, boshllëqet që vazhdojnë të ekzistojnë dhe fushat ku kërkohet koordinim më i fortë ndërmjet vendeve të rajonit. **(A2 Televizion)**

A2 CNN Livestream

MUND TE LEXONI GJITHASHTU



Ankaraja paralajmëron Athinën:
Militarizimi i ishujve në Egje është
kërcënim për Turqinë



Vuçiç përballë testit të tetorit: A po
përfundon epoka e tij, apo ndryshon
thjesht karrigen?



Lidhjet mes politikës, klubeve dhe
tifozeve: Madhërimi i Mlladiçit pa reagime
dhe sanksione



“Kaluam tronditje të mëdha!”, Vuçiç
shpërndan Parlamentin dhe shpall
zgjedhjet më 25 tetor



A do t'i ndalohet rruga në BE? Costa dhe
Von der Leyen: Të shokuar nga Serbia me
funeralin e Mlladiç



Lamtumira e një kriminel... 350 mijë
njerëz për funeralin e Ratko Mladiç, edhe
djali i Vuçiç

Latest Videos






Skandal dënimi në Hagë. Liderët e Kosovës të ulen URGJENT. Qeveri Uniteti e kontakt me SHBA



"Kur goditen ish-komandantët goditet lufta e UÇK, por dhe e ardhmja e Kosovës"



"BE duhet të reagojë, janë sponsor të kësaj gjykate, politik dhe financiar dhe vendosin mbylljen..."



Protestuesi: Gjykata NA KALLI, e kaloi dënimin që Serbia dha përgjigjet Adem Jasharin

Shqipëria Aktualitet Kronikë Politikë Ekonomi Sociale Kulturë Moti	Kosova Kulturë Sociale Ekonomi Politikë Kronikë Aktualitet	Rajoni & Bota Ballkani Bota	Argëtim Showbiz Lifestyle Kapur në kamera Teknologji	Sport Live Euro 2024 Futboll Sporte të tjera	Speciale A2 5 gjëra në 5 minuta A2 CNN në Izrael 31 Minuta A2 CNN në Ukrainë Lumi i kokainës Ditari ndërkombëtar Zbulo Imagjinatë Dëshmi	f t i y
--	---	--	---	--	--	---

Live TV

[Rreth nesh](#) [Kushtet e Privatësisë](#) [Karriera](#) [Kontakt](#)

© 2023 A2 CNN / G2 Media shpk
All Rights Reserved.

Mundësiuar nga Mediadesk

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.